



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.08, datë 02.07.2024

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:

“PËRSHTATJEN E AMBJENTEVE TË BRENDSHME TË OBJEKTIT “INKUBATORI I BIZNESIT” NË ZYRA PËR STRUKTURËN E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR”,
ME VENDNDODHJE BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht Lejes së Ndërtimit për objektin: “Përshtatjen e ambjenteve të brendshme të objektit “Inkubatori i Biznesit” ne zyra për Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, me vendndodhje Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) miratimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave për pasuritë e shpronësuara;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI

EDH RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I DREJTËSISË


ULSI MANJA



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 23 / 09 / 2024